



Pranimar / Dorezuar Prilijena / Pridato Received / Delivery	19.04	2022	2	viti god year
Organ / Njesta Organ / Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSARK	2231/2022		116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.209/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci -Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 04.03.2022 me numër A.nr.209/2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë, në Komunë të Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.209/2022 e datës 04.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KD.nr.001/2022 i datës 09.02.2022, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas kontratës për kohë të caktuar të datës 01.07.2018, në pozitën "Mbikëqyrëse" në Qendrën Korrektuese të Kosovës në Lipjan", e caktuar sipas Vendimit me numër 1219 të datës 01.01.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën Zëvendësuese e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan (Institucioni Korrektues për Femra), me datën 12.01.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankueses, me pretendimet se e njëjta ka kryer shkelje disiplinore mbi bazën e të gjeturave në raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 06.01.2022.

Komisioni Disiplinor me datën 09.02.2022 ka nxjerrë vendimin me numër KD.nr.001/2022, sipas të cilit ankuesen e ka gjetur përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallen e pagës për periudhë dy vjet".

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër KD.nr.001/2022 të datës 09.02.2022 të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datën 04.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1182/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i atakuar me ankesë përbën shkelje procedurale dhe ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 07.03.2022, ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokollit:1204/2022, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës të sipas ankesës Anr.138/2022, po ashtu dhe kërkesës për prova shtesë të datës 14.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:1182/2022 të datës 04.03.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.001/2022 të datës 09.02.2022 nga Komisioni Disiplinor; E-mail i datës 09.03.2022; shkresa për përgjigje në ankesë sipas ankesës Anr.138/2022 nga Njësia e personelit të SHKK; Vendimi nr. protokollit 1187 i datës 20.10.2021 i Komisionit disiplinor; Ndryshimi dhe plotësimi i konkursit i datës 11.02.2020; Kontratë e punës numër KI 1002031325 e datës 09.07.2013; Fletë kthesë e datës 10.08.2022; Përshkrimi i detyrave të punës e datës 03.01.2020; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 12.01.2022; Raporti i Hetimit i datës 30.12.2021 për vet varjen e të dënuarës M.K. në Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan i protokolluar me nr. 0023 me datës 11.01.2022; Raportin e datës 06.01.2022 lidhur me rastin e vetë varjes së të dënuarës me nr.protokollit 01-03; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit Medina Kasumi të datës 30.12.2021; Raportin propozues të datës 14.05.2021 nga komisioni multi disiplinor për menaxhimin e rasteve me rrezik për vetëvrasje të rasteve dhe Njoftim Email i datës 03.09.2021; Njoftimi i datës 06.09.2021 dërguar nga menaxheri i rastit dërguar për Raportin e datës 02.11.2021 mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit të datës 30.12.2021 prej 1/2 faqe; Regjistrimet ditore të gjendjes dhe sjelljeve të burgosurit të datës 28.12.2021; Njoftimin e datës 30.12.2021 për vdekjen në burg nga Raportin e datës 30.12.2021 për vet varjen e të burgosurës, nga Mbikëqyrësi i lartë i operatives; Raporti përmbledhës shëndetësor i rastit i datës 30.12.2021; Deklaratë e datës 30.12.2021 nga për rastin e Deklaratë e datës 30.12.2021 nga për rastin e M.Kasumi; Raporti mjekësor i datës 30.12.2021; Raport i ngjarjes i datës 30.12.2021 nga Raport i ngjarjes i datës 30.12.2021 nga Raport i ngjarjes i datës 30.12.2021 nga Raport i ngjarjes i datës 30.12.2021 nga Plan eventual-vdekja në burg i datës 30.12.2021 ; Shkresë zyrtare e datës 30.12.2021 nga Mbikëqyrësi i sigurimit QKFL; Deklarat nga Deklaratë nga me procesverbal intervistues me stafin të datës 31.12.2021, me prej 1/17 faqe; Kartoni i evidencës së vizitorëve sipas listës së planifikuar Forma3.3.2 /1; Raporti lidhur me shërbime psikologjike të ofruara të rastit i datës 30.12.2021; Raport mjekësor nga Ministria e shëndetësisë departamenti shëndetëso i burgut i datës 15.09.2020 QKUK-IPFK; Raport mjekësor nga

Ministria e shëndetësisë departamenti shëndetëso i burgut i datës 15.02.2021 QKUK-IPFK; Fletë lëshim i datës 25.03.2021; Shkresë nga Ministria e Shëndetësisë i datës 28.04.2021 nga Departamenti Shëndetësor i Burgut prej 1/12 faqe; Aktvendimin e Panelit për masë të paraburgimit i datës 27.04.2021 me numër P.nr.328/2021; Aktgjykimin me numër P.nr.328/21 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm i datës 25.05.2021; Aktgjykimin me numër PA1.nr.798/2021 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 19.08.2021; Vendim nr. protokolli 1565 i datës 31.12.2021 për formimin e komisionit të brendshëm hetimor lidhur me rastin e vdekjes së M.K; Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht me numër PLK.D.nr.563/21; Raportin e datës 27.09.2021 përmbledhëse për lirim me kusht për të dënuarën Kualifikimi i datës 20.09.2021 për shqyrtim për lirimin me kusht për të dënuarën Raportin e datës 27.09.2021 përmbledhëse nga ekipi profesionalist i Institucionit Korrektues për Panelin për lirim me kusht; Raport shëndetësor për të burgosurën i datës 23.09.2021 prej 1/3 faqe; Deklaratë e datës 24.09.2021 nga e burgosura Raporti Socila i datës 27.09.2021 prej 1/4 faqe; Kualifikimi i datës 21.09.2021 për shqyrtim për lirimin me kusht për të dënuarën Deklarim -i datës 23.09.2021 nga zyrtari sporvues- premtim lidhur me mbikëqyrjen pas lirimit me kusht; Raport përmbledhës për Gjykatë për lirim të parakohshëm i datës 23.12.2021 prej ½ faqe; Email i datës 24.12.2021 Raport për lirim të parakohshëm për M.K; Raport i datës 04.10.2021 vlerësimi për regjime prej ½ faqe; Vendim i datës 07.05.2021 i komisionit disiplinor ndaj M.K.; Raporti iniciues disiplinor i datës 06.05.2021 me shënim zyrtar prej 1/2 faqe; Vendim i datës 06.10.2021 nga komisioni disiplinor; Raporti iniciues disiplinor i datës 05.10.2021 me shënim zyrtar deklarata prej 1/4 faqe; Procesverbale i intervistës me stafin i datës 24.01.2022 dhe datës 25.01.2022 prej 1/22 faqe; Raporti iniciues disiplinor i datës 02.09.2021 prej 1/2 faqe; Raporti iniciues disiplinor i datës 06.04.2021 me shënim zyrtar deklarata prej 1/4 faqe; Plani eventual-vdekja në burg i datës 30.12.2021; Kartoni i evidencës së vizitorëve sipas listës së planifikuar Forma 3.3.2/1, me shkresën e vizitave të M.K; Raporti mbi gjendjen shëndetësorë të paraburgosurve i datës 03.09.2021; Informata për të burgosur i datës 28.07.2000; Raporti mbi gjendjen shëndetësorë të paraburgosurve i datës 03.09.2021; Procesverbali i datës 22.01.2022 i intervistës me stafin prej ¼ faqe; Ftesë për intervistë i datës 21.01.2022 nga kryesuesi i Komisionit disiplinor, prej 1/4 faqe; Raport propozues nga Komisioni multi-disiplinor për menaxhimin e rasteve me rrezik për vetëvrasje të rasteve dhe e mitur i datës 14.05.2021; Shënim zyrtar i datës 30.12.2021 prej ½ faqe; Deklaratë e datës 31.12.2021 regjistrim ditor i datës 30.12.2021; Deklaratë e datës 31.12.2021 Raporti i ngjarjes i datës 30.12.2021; Raport mbi gjendjes shëndetësore të para-gurosurve i datës 02.11.2021 prej ½ faqe; Raport mbi gjendjes shëndetësore të para gurosurve i datës 16.09.2021 prej ½ faqe; Raportin e ngjarjes të datës 30.12.2021 nga për të burgosurën; Raportin e datës 02.11.2021 mbi gjendjen shëndetësore të paraburgosurve; Raportin e ngjarjes se datës 30.12.2021 nga Raportin e ngjarjes se datës 30.12.2021 nga Raporti i vetëvrasjes së të burgosurës nga Mbikëqyrësi i lartë operativi datës 30.12.2021; Njoftimi per vdekje në burg i datës 30.12.2021; E-mail i datës 30.12.2021; Raporti i ngjarjes i datës 30.12.2021 nga E-mail i datës 15.04.2022 , prova shitesë Kontratë e punës e datës 30.06.2018, numër i KI 1015286047, me përshkrim të detyrave të punës 03.01.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.209/2022 e datës 04.03.2022, e parashtruar nga ankuesja është e *pabazuar*, sepse:

Me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafin 1 është përcaktuar se: *“Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë”*, nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe legjislacionit të veçantë.

Po ashtu Kolegji, me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka marrë parasysh specifikat e institucionit sikurse edhe çështjen e legjislacionit të veçantë i përcaktuar si në nenin 4 paragrafin 2 nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përcaktohet se: *“Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutimin; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve”*.

Në bazë të shkresës së përgjigjes në ankesë të datës 15.04.2022 e ofruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është bashkangjitur edhe Vendimi me numër 1219 i datës 01.11.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit me të cilin vendim e ankuesja është caktuar në pozitën Zëvendësuese e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan (Institucioni Korrektues për Femra) respektivisht në bazë të këtij vendimi ankuesja ushtron përkohësisht pozitën e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan (Institucioni Korrektues për Femra).

Bazuar në raportin hetimor të inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë të datës 30.12.2022, lidhur me rastin e vetvarjes së të dënuarës M. K në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, Kolegji pas analizimit dhe dhënies së rekomandimeve të këtij komisioni lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankueses, ka konstatuar se tek rasti i ankueses ka gjetur në piken e tretë si në vijim, citoj: *“Inspektorati ka kërkuar edhe deklaratat me shkrim nga Zëvendësuesja e Drejtorit Zëvendës Drejtoresha dhe Udhëheqësja për komunikimin që ka udodh përmes “sms”, ku dhe është urdhëruar mbyllja e të dënuarës M.K në dhomë, pa rekomandim me shkrim nga psikologu”*, andaj ndërlidhur me këtë Kolegji ka vlerësuar se edhe pse në bazë të shkresave të lëndës tanimë e ndjera M.K kishte qenë me terapi dhe në observim nga data 10.09.2021 nga 15 deri 30 min , e njëjta ishte urdhëruar të mbyllet në dhomë pa pasur rekomandim nga ana e psikologes ,mirëpo vetëm me anë të një sms-i që kishte qenë urdhër nga Zëvendësuesja e Drejtorit drejtuar udhëheqëses së pavilonit me arsyetimin se kinse pasi ka pranuar një informatë nga lidhur me atë së tanimë e ndjera e kishte pyetur një të dënuar se sa mund të dënohem nëse e mbys dikend me jastëk. Kolegji pas analizimit të kësaj situatë vlerëson se zingjiri ndërveprues i hierarkisë pranë institucionit të Shërbimit Korrektues në këtë rast nuk ka funksionuar fare, ngase nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura në kohën reale për rastin e tanimë të ndjeres M.K, ku e njëjta ishte dashur të mbikëqyret për veprimet e saja herë pas here siç ka qenë edhe urdhër nga ana e psikologes ,ngase ka qenë me tretman mjekësor e jo të vie deri tek rasti i vetvarjes nga ana e tanimë të ndjeres, andaj ndërlidhur me situatën e lartcekur, Kolegji konstaton se ankuesja ka bere shkelje gjate procedurës se mbylljes se M.K nga urdhëresa përmes

telefonit pa pasur rekomandim nga psikologu dhe neuropsikiatri si dhe në bazë të përshkrimit të detyrave të punës ankuesja ka qenë e obliguar të menaxhojë situatën në atë mënyrë që kur është në pyetje siguria e të burgosurave të reagoj dhe të ndërmar veprimet e duhura për zgjidhjen e situatës në mënyrën sa më të mirë dhe më të lehtë, e meqenëse ky veprim ka munguar nga ana e saj Kolegji konstaton se e njëjta është përgjegjëse lidhur me mbylljen e M.K përmes telefonit pa pasur rekomandim nga psikologu dhe neuropsikiatri si dhe mos menaxhim të kësaj situatë që si rezultat ka humbur jetën një e burgosur e cila kishe qenë me probleme psiqike dhe tretman të vazhdueshëm psikologjik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar edhe vendimin e komisionit disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku për rastin e ankueses ka elaboruar veprimet përgjegjëse të ankueses ndërlidhur me rastin e tani më të ndjerës M.K, ku ndër të tjera thuhet se, citoj: *“Zëvendësuesja e Drejtorit përkundër që ka qene e angazhuar nga Drejtori i Përgjithshëne komisione tjera, e njëjta nuk ka marr masa për trajtimin e informatës në mënyrën e duhur nuk ka kërkuar raport me shkrim nga vartësit për gjendjen e të dënuarës si dhe nuk është kujdesur të merr mendimin e mjekut / psikologut para mbylljes se të dënuarës të cilës i janë ndaluar aktivitetet ditore në cilësinë e Zëvendësueses së Drejtoreshës nuk është kujdesur që përmes sistemit të kamerave të sigurohet se observimi i të dënuarave është duke u kryer sipas rekomandimeve të mjekut, nuk ka vizituar të dënuarën e mbyllur për rreth dy dite pavarësisht që e njëjta ka qene e mbyllur me vendimin e vete Drejtoreshës ‘andaj mbi këtë bazë, Kolegji konstaton se vendimi i komisionit disiplinor është i bazuar ngase ankuesja me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës është përgjegjëse për shkeljet e kryera, ashtu siç përcaktohen në nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës”.*

Po ashtu, Kolegji me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar edhe dispozitat e nenit 45 të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”* si dhe nenit 50 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”* dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor, ankueses i ka shqiptuar masën në proporcion me përgjegjësinë disiplinore dhe me rastin e shkeljes së rëndë të detyrave të punës siç përcaktohet me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku thuhet se: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”* ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në*

paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor", nga ku rrjedh se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore për ankuesen, i ka marrë për bazë parimet e individualizimit të masës, veprimet e tjera të mëhershme me qëllim kufizimit të dëmit, andaj bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë, pretendimet e ankueses janë të pabazuara në ligj dhe njëkohësisht të paqëndrueshme.

Kolegji po ashtu thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.001/2022 të datës 09.02.2022 i ka shqiptuar masën e ndryshme disiplinore tetë (8) zyrtarëve të cilët i ka gjetur përgjegjës për rastin e lart cekur, ndërsa refuzimi i ankesës së ankueses së datës 04.03.2022 dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Disiplinor ka të bëjë vetëm me pikën I të dispozitivit, ku përcaktohet në mënyrë taksative masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses dhe e njëjta e pakënaqur me këtë masë ka iniciuar procedurën administrative me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës të Shërbimit Civil, andaj meqenëse ankesa ka qenë individuale, Kolegji konstaton se në këtë rast nuk mund të lëshohet përtej kompetencave dhe ka vendosur vetëm për rastin e ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.209/2022.

Zyler Millaku GOJNOVCI
Proçesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

